



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-150, dhe nenin 85, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucioneve Financiare Jobankare, Bordi i Bankës Qendrore i Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2024, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PARIMET E MENAXHIMIT TË RREZIKUT TË VENDIT DHE TË TRANSFERIT

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të krijojë standardet minimale të pranueshme për qasjen e bankave për menaxhimin e rreziqeve të vendit dhe të transferit me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së bankave dhe kontribuimit në stabilitetin financiar.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë sikurse përkufizohen në Ligjin Nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (në vijim: Ligji për Bankat) dhe/ose sipas përkufizimeve në vijim për qëllimin e kësaj rregulloreje:
 - 1.1. **Rreziku i vendit** – nënkupton rrezikun e humbjes të shkaktuar nga ngjarjet në një vend të huaj, që mund të përfshijnë ndryshimet në kushtet ekonomike, shoqërore, politike ose rregullatore të cilat ndikojnë tek personat fizik apo juridik që kanë detyrime në atë vend, dhe potencialisht detyrimet e përcaktuara në valutën e atij vendi.
 - 1.2. **Korniza e menaxhimit të rrezikut** – nënkupton kornizën përmes së cilës Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti i Lartë krijojnë dhe marrin vendime lidhur me strategjinë dhe qasjen e rrezikut të bankës, artikulojnë dhe monitorojnë respektimin e gatishmërisë së bankës për të marrë rrezik dhe limitet e rrezikut lidhur me strategjinë e bankës; dhe identifikojnë, matin, menaxhojnë dhe kontrollojnë rreziqet.
 - 1.3. **Limitet e rrezikut** – nënkupton masat specifike kuantitative që nuk mund të tejkalohen, bazuar në supozimet që shpërndajnë gatishmërinë e bankës për të marrë rrezik në nivel të përgjithshëm tek linjat e biznesit, entitetet ligjore ose njësitë menaxhuese brenda bankës ose grupit bankar në formën e kategorive të veçanta të rrezikut, koncentrimëve, ose masave të tjera, sipas rastit.
 - 1.4. **Sistemi i menaxhimit të rrezikut** – nënkupton së bashku, sistemet, strukturat, politikat, procedurat dhe individët që matin, monitorojnë dhe raportojnë rrezikun në kuadër të bankës në përgjithësi ose nëse është e aplikueshme në kuadër të grupit bankar në përgjithësi.

- 1.5. **Rreziku i transferit** – nënkupton rrezikun që huamarrësi nuk do të jetë në gjendje të konvertojë valutën vendore në valutë të huaj dhe në këtë mënyrë të mos jetë në gjendje të kryejë shërbimet e pagesave të borxhit në valutë të huaj.

Neni 3

Korniza e menaxhimit të rrezikut

1. Bordi i Drejtorëve të bankës dhe menaxhmenti i lartë duhet të sigurojnë që korniza e menaxhimit të rrezikut të vendit dhe transferit të përfshijë menaxhim efektiv të pavarur të rrezikut, kontrollet e brendshme dhe proceset e auditimit.
2. Menaxhimi i pavarur i rrezikut dhe sistemi i kontrollave dhe auditimit të brendshëm duhet të mbulojnë në mënyrë adekuate të gjitha aktivitetet dhe ekspozimet në një vend të huaj.
3. Korniza e menaxhimit të rrezikut të bankës duhet të përfshijë politika dhe procedura për identifikimin, matjen, monitorimin dhe raportimin mbi rrezikun e vendit dhe të transferit, të rrezikut në financimin ndërkombëtar të bankës, huadhënien dhe investimet në kohë.
4. Korniza e menaxhimit të rrezikut duhet të sigurojë një pasqyrë në gjithë bankën, ose nëse është e aplikueshme, në gjithë grupin bankar të rreziqeve të vendit dhe transferit, duke përfshirë, aty ku është e përshtatshme, ekspozimet brenda grupit.
5. Bankat me ekspozim ndaj rreziqeve të vendit dhe transferit, në kuadër të kornizës së menaxhimit të rrezikut duhet, të paktën, të përfshijë pikat e mëposhtme:
 - 5.1. Limitet e rrezikut të vendit dhe transferit të përcaktuara në gatishmërinë e bankës për të marrë rrezik (ang. risk appetite) të miratuar nga bordi i drejtorëve;
 - 5.2. Dokumentimi i roleve dhe përgjegjësi të njëjësive të ndryshme të bankës të përfshira në menaxhimin e rrezikut të vendit dhe transferit;
 - 5.3. Përkufizimi i rreziqeve të vendit dhe transferit duke marrë parasysh madhësinë dhe natyrën e ekspozimeve ndërkufitare në raport me gjithsej aktivitetin e bankës;
 - 5.4. Politikat dhe procedurat për të siguruar që të gjitha rreziqet e vendit dhe transferit janë identifikuar, matur, menaxhuar, zbutur dhe raportuar në kohën e duhur dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse;
 - 5.5. Politikat dhe procedurat për të siguruar që zhvillimet që ndikojnë në rreziqet e vendit dhe transferit janë monitoruar, dhe aty ku kërkohet, përdoren kundërmasa të përshtatshme si zvogëlimi i limiteve të ekspozimit ose janë përdorur teknika të tjera; dhe
 - 5.6. Politikat dhe procedurat për të siguruar që provizionimi pasqyron minimumet e matura të bazuara në standardet e brendshme për ekspozimin ndaj secilit vend përkatës ose përmes shqyrtimit eksplicit të rrezikut të vendit dhe transferit në provizionimin për ekspozimet individuale.

Neni 4

Sistemi i menaxhimit të rrezikut

1. Banka duhet të identifikojë, matë, monitorojë dhe kontrollojë rrezikun duke zbatuar një sistem efektiv të menaxhimit të rrezikut i përshtatshëm për madhësinë dhe kompleksitetin e operacioneve të saj.
2. Sistemi i menaxhimit të rrezikut duhet të përfshijë politikat, procedurat, sistemet dhe kontrollat për monitorimin dhe raportimin për të siguruar që ekspozimet ndaj rrezikut të vendit dhe transferit

janë në përputhje me strategjinë dhe planin e biznesit të bankës dhe në përputhje me gatishmërinë e bankës për të marrë rrezik (ang. risk appetite) dhe limitet individuale të rrezikut të miratuar nga Bordi i Drejtorëve.

3. Menaxhimi i rrezikut të vendit dhe transferit duhet të jetë brenda funksionit të përgjithshëm të menaxhimit të rrezikut të bankës.

Neni 5 **Stres testi**

Banka me ekspozim ndaj rreziqeve të vendit dhe transferit duhet të përfshijë në stres testet e saj skenarë të përshtatshëm që pasqyrojnë goditjet e mundshme, për të vlerësuar ndikimin e tyre të mundshëm në fitimet e bankës, operacionet dhe kapitalin e saj.

Neni 6 **Sistemet e informacionit dhe raportimi i brendshëm**

Banka duhet të ketë sisteme të informacionit që i mundësojnë të agregojë, monitorojë dhe raportojë me saktësi ekspozimet e vendeve. Raportet duhet t'i sigurohen Bordit të Drejtorëve dhe menaxhmentit të lartë në kohë, në formate të përshtatshme për përdorimin e tyre.

Neni 7 **Raportimi në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës**

1. Banka duhet të sigurojë sipas kërkesës çdo informacion specifik në lidhje me rrezikun e vendit dhe transferit që BQK -ja mund të kërkojë.
2. Banka duhet të njoftojë menjëherë BQK-në kur zbulon një devijim të konsiderueshëm nga limiti për rrezikun vendit dhe transferit të përcaktuar në politikat e miratuara nga Bordi i Drejtorëve, ose zbulon se një rrezik i vendit ose i transferit nuk është adresuar në mënyrë adekuate.

Neni 8 **Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile**

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, sikurse përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për Bankat.

Neni 9 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi më 30 shtator 2024.

Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës